

ALBANŠČINA
(bere Aleksandar Trifunović)

Mihal Grameno, *Oxhaku*

Pjesa e parë, krye I

Më 1821, në kohën e Ali Pashës Shqipëria, dhe më shumë Toskëria gjendeshe në rrëmujë. Katunde edhe qytete shkretoheshin dhe njerëzia mërgoheshin në vende të huaj, duke lënë shtëpitë, plaçkat e gjithë ç’kishin edhe vështroinin vetëm si e si të shpëtojnë nga rreziku shpirtin e tyre.

Asi kohe, qyteti Korça kishte zënë të lulëzonjë, duke qenë më parë një qyteti i vogël edhe i padëgjuar siç është sot, po njerëzia dridheshin nga frika se mos kenë gjithë atë fat që kishin edhe të tjerët të cilët ngryseshin të gjallë e gdhiheshin të vdekur. Andaj, me të perënduar dielli, mbylleshin nëpër shtëpitë edhe nuk dinin ç’bëhesh natën në qytet.

Nga ky shkak nuk kishin vërejtur që “shtëpia e zezë” prej ca kohe mbante njerëz brenda.

“Shtëpia e zezë”, siç e quanin qytetarët ishte një shtëpi e madhe, ndërtuar me gurë dhe rrethuar më gjithë anët me avlli edhe fortesa edhe ishte mbanë qytetit pranë kroit të Abdi beut. Prej shumë kohe, kjo shtëpi ishte e pandënjur edhe e shkretuar, të gjithë sa kishin ndenjtur, gjithë atë fat kishin pritur që të shuhen me gjithsej, edhe nga ky shkak kishte arritur të jetë fole e kukumjaçkave edhe e galave, se njerëzia jo vetëm që nuk guxon të ryjnë brënda, por edhe kur shkonin pranë asaj shtëpie do të faleshin me tmerr, duke iu lutur zotit t’i shpëtonjë edhe t’i mbronjë nga ndonjë gjëmë e madhe.

Në të këtilla frikëra gjendeshin korçarët, kur një natë të marsit frynte një erë e marrë edhe dëgjojnë të zbrazura prej pushkësh. Të gjithë mbetnë të tmerruar, se pandeshnin që afrojtë edhe për ata fundi i jetës. Andaj që të gjithë faleshin, duke kërkuar nga nonjë vent të fshehtë për shpëtimin e shpirtit, edhe asnjë nuk guxonte të dalë përjashta që të mësonjë shkakun e pushkëve.

Po sa vinte më shumë dëgjoheshin të zbrazura prej pushkësh, pastaj dëgjoheshin edhe zëra njerëzish, të cilët bërtisnin sa muntnin që të vraponin të shuanin zjarrin që diqte shtëpinë e zezë, se ishte shumë frikë mos përhapet zjarri mi gjithë qytet.

Mihal Grameno, *Ognjišče*

Prvi del, prvo poglavje

Leta 1821, v času Alipaše, je bila Albanija, še posebej pa ozemlje Toskov, razdejana. Vasi in mesta so bili opustošeni, ljudje so bili pregnani v tuje dežele, zapustili so svoje domove, premoženje in vse, kar so imeli, ter so zgolj iskali način, kako svoje duše rešiti pred nevarnostjo.

Takrat je mesto Korča začelo cveteti; prej je bilo to namreč majhno in nepoznano mesto, drugače kot danes, in ljudje so trepetali, da jih ne bi doletela enaka usoda kot druge, ki so zaspali živi in se zbudili mrtvi. Zato so se po sončnem zahodu zaprli v svoje domove, ponoči pa v mestu niso imeli kaj iskati.

Zato tudi niso opazili, da v »črni hiši« že nekaj časa živijo ljudje.

»Črna hiša«, kot so ji pravili meščani, je bila velika hiša, zgrajena iz kamnov in z vseh strani obdana z dvoriščem in obzidjem, stala pa je v bližini Abdibegovega vodnjaka. Dolgo časa je bila ta hiša nenaseljena in zapuščena – vse, ki so tam živeli, je dočakala ista usoda: njihov rod je usahnil in zato je hiša postala gnezdo sov in vran, ljudje pa ne le, da si niso upali vstopiti, temveč so tudi, ko so šli mimo, molili k Bogu in ga rotili, naj jih reši in obvaruje vsega hudega.

Takšni strahov so preganjali Korčane, ko je neke marčevske noči zapihal blazen veter in so zaslišali strele pušk. Vsi se preplašili, saj so mislil, da se njihova življenja bližajo koncu. Zato so vsi molili, iskali zatočišče za svoje duše in nihče si ni upal stopiti ven, da bi izvedel od kod se slišijo streli.

Vse bolj so se slišali streli pušk, potem pa so se zaslišali glasovi ljudi, ki so na vso moč klicali, naj pritečejo gasit ogenj, ki je gorel v črni hiši, saj so se močno ustrašili, da bi se ogenj razširil na vse mesto.

Prevedel Aleksandar Trifunović.